

08.11.2017 NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË**

**RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me kryetarin e trupit gjykues Musa Konxheli, asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale ndaj te pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED], Komuna e [REDACTED], për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.22/17 te dt. 24.04.2017 në praninë e Prokurorit të shtetit [REDACTED], të pandehurit [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më dt.29.09.2017 sjell dhe publikisht shpalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna e [REDACTED], i lindur me datë [REDACTED] në [REDACTED], me vendbanim në [REDACTED] i biri i [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka te kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Me datën 13.02.2017 rreth ores 01:45 në fshatin Kaçanik i Vjetër, Komuna e Kaçanikut, ka poseduar pa autorizim me qëllim shitje substancë narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që deri sa ka qenë duke u shëtitur me të miturin [REDACTED] është ndalur nga njësia patrulluese e Stacionit Policorë në Kaçanik gjatë kontrollit për siguri në trupin e të pandehurit, i pandehuri ka nxjerrë nga xhepi i jaknes një qese të plastikës me 16 paketime, me peshë bruto 19,11 gram të cilat i ka hedhur në hapsirën e gjelbëruar përreth rruge, e cila sekuestrohet përkohësisht nga policia.

me të cilën ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1, të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat ligjore te neneve 3, 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 52, 73, 75, 76 par.1 nenpar.1.3 te KPRK-se dhe nenit 359 e 365 te KPPRK-se

## AKTGJYKIM FAJESUES

### G J Y K O N

I pandehuri [REDAKTUAR]

**DENIM ME GJOBË** në shumën prej 200 euro i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërise se ketij aktgjykimi nën kërcenimin e përmarimit me dhunë,

**ME DËNIM BURGIMI:** në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, cili dënim nuk do te ekzekutohet nese i pandehuri gjate periudhes verifikuese ne afat prej 2 viteve nga plotefuqishmeria e ketij aktgjykimi nuk kryen veper penale tjeter te kesaj natyre.

Konform nenit 273 par.5 të KPPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme: substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë bruto 19,11 gram.

I akuzuari [REDAKTUAR] obligohet që në emër të shpenzimeve ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30/tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktgjykimi.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.22/17 të datës 24.04.2017 ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29.09.2017, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit [REDAKTUAR] mbeti në tersi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën e ngarkon aktakuza, në të gjitha pikat e saj dhe shton se është penduar thellë për këtë veprë penale dhe premtion se nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme, lut gjykatën që të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,
  - pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,
  - pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe ate, vërtetimi mbi sekuestrimin e lëndës narkotike i dt. 13.02.2017, Fotografitë për lëndën narkotike, Raporti i ekspertimit i AKS-së me nr. AKF/2017-0520/2017-469 i dt. 13.04.2017, Deklarata e të miturit [REDAKTUAR] Deklarata e Dëshmitarit [REDAKTUAR]
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ( *nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin*



*gjkues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013)*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen tiparet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 273 par.5 të KPPRK-së, konfiskohen në mënyre të përherëshme: substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë bruto 19,11 gram.

Konform nen. 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nga arsyet e sipër cekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE  
RENDA,,  
PKR.nr.63/17 dt. 02.10.2017**

**Asistenti**

Muedin Rexhepi

**Kryetari i trupit gjykues**

Musa Konxheli



**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.